



TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve me Likuidim Nr. 32 - Njësia nr. 75

Fapol Podujevë

Emri i NSH.-së	NSH "Fapol" ("Ndërmarrja")
Lloji i shitjes	Shitja me Likuidim me ofertë të mbyllur
Dita e Ofertimit	24.05.2017 në Zyrën Qendrore të AKP-së
Regjistrimi i Ofertuesit	Deri më 17.05.2017 në Zyrën Qendrore të AKP-së
Depozita e Ofertës	250,000 Euro
Vendndodhja e Aseteve	Podujevë
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	Fapol Podujevë përfshinë ish hapësirat e fabrikës ku hyjnë disa halla prodhimi, depo të ndryshme, ndërtesa administrative, etj. Të gjitha këto objekte kanë një sipërfaqe totale prej 13338 m ² , objektet kryesore me sipërfaqe prej 11577 m ² , si dhe objektet tjera përcjellëse si trafo, restoranti, ngrohtorja, etj, me sipërfaqe totale prej 1761m ² . Qiramarrësi aktual ka bërë një zgjerim (montazh) në hallën e prodhimit me sipërfaqe prej 958 m ² , dhe kjo hapësirë nuk është pjesë e kësaj shitje.
Ndërtesat dhe tokat	Asetet gjendet në rrugën "Zahir Pajaziti" nr. 196 afër kryqëzimit të magjistrales Podujevë - Prishtinë. Nuk ka tokë të përfshirë në këtë tender. Shënim me rëndësi: Zyra Rajonale në Prishtinë përkundër përpjekjeve nuk ka arritur që të vij në dispozicion të dokumenteve konkrete pronësore, Identifikimi i asetëve është bërë në bazë të listës së objekteve nga "Raporti i Inventarizimit të Auditimit" si dhe me ndihmën e ish Menaxhmentit të NSH Fapol. NSH-ja është në posedim faktik me mirëbesim të tokës dhe objekteve që nga themelimi i NSH-së në vitet e 1970-a. Komuna asnjëherë nuk ka sqaruar se si është e mundur që për një kompleks si ky i Fabrikës nuk ka dokumente në bazë të së cilave është ndërtuar kjo fabrikë dhe ka operuar për më se 20 vite deri në qershorin e vitit '99.

Informatat që janë dhënë në këtë publikim mund të kenë pasaktësi, lëshime, ose gabime tipografike për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjëse e as nuk do të pranojë përgjegjësi lidhur me përdorimin, vlefshmërinë, saktësinë, plotësinë ose besueshmërinë, pa marr parasysh natyrën e tyre. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dosjen elektronike dhe dokumentet për ofertim. Është në përgjegjësinë e secilit ofertues të mundshëm, që të bëjë hulumtimin paraprak në lidhje me NSH-në apo artikujt e tenderuar, me qëllim të mbledhjes së informatave të nevojshme. Këto të dhëna janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme të cekura në Rregullat e Tenderit të cilat mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: www.pak-ks.org.



Ekziston apo posedojmë edhe dokumentin e ashtuquajtur Projekti Investiv për ndërtimin e njërit nga repartet për prodhimin e shtyllave të plastikes, të përpiluar nga SMELT, Lubjana, Slloveni në vitin 1981. Ky projekt përfshin të gjitha aspektet e projektit për ndërtimin respektivisht zgjerimin e fabrikës, konkretisht në faqen nr.11 seksionin nr.9 LOKACIJA (LOKACIONI) theksohet (citojmë): “Fabrika e re për prodhimin e shtyllave të poliesterit do të vendoset në lokacionin e OP “Fapol” afër godinës ekzistuese për përpunimin e rrëshirës... Më tej në faqen nr.106 seksioni nr. 9.2.2. VLASNISTVO ZEMLJISTA (PRONËSIA E TOKËS) theksohet (citojmë): Mikrolokacioni i uzinës së re ndodhet në tokën industriale të OP “Fapol”, ku ekziston mundësia e zgjerimit për zhvillim afatgjatë... “.

Sipërfaqet e aseteve janë të bazuara në matjet të kryera në terren (me shirit metër).

Objektet gjenden në ngastrën kadastrale me nr.1541, ZK Podujevë, e cila është e regjistruar në emër të Komunës së Podujevës. Zyra Rajonale e Prishtinës e AKP-së ju ka drejtuar me kërkesë zyrtare Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi të Komunës së Podujevës me datën 28.08.2012 dhe me 28.04.2014 për regjistrimin e ngastrës me nr. 1541 në emër të NSH Fapol.

Me 24.03.2017 Kryetari i Komunës së Podujevës iu është drejtuar me një shkresë AKP-së me të cilën njofton që prona në fjalë është në pronësi të Komunës dhe nuk mund ti bëjnë ndryshimet e kërkuara pasi paraqet vepër penale, pasi që AKP nuk posedon dokumente relevante për ndryshimin e titullarit të pronës. Po ashtu, ka njoftuar me vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të palestrës së sporteve në Podujevë, në ngastrën në fjalë.

Në vazhden e veprimeve të ndërmarrura nga AKP-ja, kjo e fundit me shkresën e datës 18.09.2013, kishte kërkuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, që ta obligoj Kuvendin Komunal të Komunës së Podujevës, që ta pezulloj vendimin për ndryshimin e titullarit të pronësisë për paluajtshmerinë lëndore respektivisht për ngastrën kadastrale nr. 1541.

Provë: Shkresa e AKP-së e datës 18.09.2013

Me 21.02.2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka pranuar shkresën nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal gjegjësisht nga ministri i kësaj ministrie, ku në mes tjerash thuhet, cituar: “Vendimi i Kuvendit të Komunës së Podujevës është i kundërligjshëm dhe kërkon nga i njëjti organ që ta rishqyrtoj aktin në fjalë dhe të ndërmarr të gjitha masat dhe veprimet konkrete në mënyrë që vendimi të jetë në pajtueshmëri me ligjet e



aplikueshme në Republikën e Kosovës”.

Po ashtu në shkresën tjetër të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, të datës 27.09.2013, me nr. të protokolit 463-1219, drejtuar Kryetarit të Komunës së Podujevës, Ministria kërkon shprehimisht nga Komuna e Podujevës, që ti ndërmerr veprimet e nevojshme për kthimin e pronës së paluajtshme të Ndërmarrjes Shoqërore “Fapol”, nga regjistri i pronës Komunale në regjistrin e pronave të menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Me 31.05.2016, AKP-ja ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, për vërtetimin e pronësisë me propozim për caktimin e masës se përkohshme te sigurisë, kundër Komunës së Podujevës.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, e ka refuzuar propozimin për lëshimin e masës se përkohshme te sigurisë ndaj te cilit AKP-ja ka ushtruar ankese. Po ashtu Gjykata e Apelit e ka refuzuar ankesën e AKP-se. Gjykata ende nuk ka vendosur lidhur me meritat e padisë.

Prona e NSH FAPOL ka qene e komercializuar qe nga viti 2001 deri me 30.06.2012.

Shfrytëzuesit

Aktualisht objektet janë duke u shfrytëzuar me qira nga Jaha Company përmes kontratës për qiradhënie që nga data 1 nëntor 2015. Kontrata në fjalë është vazhduar, ndërsa skadon me 30 prill 2017.

Përshkrimi i Aseteve

J/A

Asetet tjera

Detyrimet që do të barten

Nuk ka detyrime që do të transferohen tek pronari i ri, megjithatë blerësi duhet të ketë parasysh se tatimi mbi transferimin e pronësisë mund të aplikohet.

Foto/fotot
Ose informata të tjera
Për asetet në shitje



Informatat

Departamenti i Shitjes – Njësia e Marketingut
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255
Fax: +381 (0) 38 248 076
www.pak-ks.org

Dokumentet e
Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga: Agim Ramadani nr.23
10000 Prishtinë, Kosovë

Informatat që janë dhënë në këtë publikim mund të kenë pasaktësi, lëshime, ose gabime tipografike për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjëse e as nuk do të pranojë përgjegjësi lidhur me përdorimin, vlefshmërinë, saktësinë, plotësinë ose besueshmërinë, pa marr parasysh natyrën e tyre. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dosjen elektronike dhe dokumentet për ofertim. Është në përgjegjësinë e secilit ofertues të mundshëm, që të bëjë hulumtimin paraprak në lidhje me NSH-në apo artikujt e tenderuar, me qëllim të mbledhjes së informatave të nevojshme. Këto të dhëna janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme të cekura në Rregullat e Tenderit të cilat mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: www.pak-ks.org.